



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 10 Prot.

Vlorë, më 15 / 02 / 2019

V E N D I M

Nr. 1 , datë 13.02.2019

"PËR MIRATIMIN E RAPORTIT VJETOR TË VEPRIMTARISË SË KOLEGJIT
UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË" PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018

Bazuar në pikën 1 të nenit 37, pikën 1 të nenit 38,germa "g", të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"; në Udhëzimin nr.5,datë 19.02.2018 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë", në pikën 1 dhe në pikën 2 germa "m" të nenit 9, të Statutit të Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë", miratuar me Urdhër nr. 586, datë 15.12.2016 të ministrit të Arsimit dhe Sportit; si dhe nenet 13, të Rregullores së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" (në vijim KUPV); në mbledhjen e përbashkët të Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit të KUPV; Senati Akademik i KUPV,

V E N D O S I:

1. Të miratojë raportin e detajuar vjetor të veprimtarisë së Kolegjit Universitar "Pavarësia Vlorë" për vitin akademik 2017-2018;
2. Ky raport të përcillet për depozitim pranë Ministrisë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë ;
3. Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Gëzim LIÇAJ

